Udhëzuesi për Linjën e Integritetit të Trans Adriatic Pipeline AG

Trans Adriatic Pipeline AG

Lindenstrasse 2, 6340 Baar, Zvicër

www.tap-ag.com

Të Drejtat e Autorit të Rezervuara: Ky dokument nuk mund të kopjohet, t'u dorëzohet apo t'u vihet në dispozicion palëve të treta pa pëlqimin paraprak nga TAP AG. Versioni fundit i dokumentit është regjistrua në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Dokumentacionit të TAP-it.

1. HYRJE

Në kuadër të angazhimit për standardet më të larta etike dhe profesionale, dhe me qëllim mëkimin e një mjedisi ku çdokush ndihet i lirë të flasë dhe ngrejë zërin, si dhe duke marrë në konsideratë legjislacionin aktual, Trans Adriatic Pipeline AG ("TAP") harton udhëzuesin e mëposhtëm ("Udhëzuesi"). Është kritike që TAP-i të ruajë reputacion të padiskutueshëm dhe që të konsiderohet vazhdimisht si partner profesional dhe i besueshëm nga klientët, furnitorët dhe palët e tjera të interesit.

Ky udhëzues është hartuar duke marrë në konsideratë legjislacionin aktual në fuqi: (i) Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2019 për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të legjislacionit të Bashkimit, (ii) transpozimin e saj në Dekretin Ligjor Italian 24/2023 dhe Ligjin grek Nr. 4990/2022, dhe (iii) Ligjin shqiptar Nr. 26/2016 "Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" ("Legjislacioni Përkatës"). Kodi i Sjelljes i TAP-it dhe Programi Model 231 i TAP-it janë marrë gjithashtu në konsideratë në lidhje me nxjerrjen e këtij Udhëzuesi.

Ky Udhëzues siguron një rrugë komunikimi shtesë për raportimin e shkeljeve të sjelljes, sipas shpjegimit më poshtë. Megjithatë, mbase ju ndiheni më të lirë t'ia raportoni shqetësimet tuaja dikujt që i besoni në TAP, ose përmes kanaleve të komunikimit tashmë të vendosura.

Në këtë kuadër, ju lutemi të vini re se përveç Linjës së Integritetit, ka edhe kanale të tjera përmes të cilave palët e brendshme dhe të jashtme mund të raportojnë pretendime lidhur me shkelje të Kodit të Sjelljes së TAP-it. Përveç Linjës së Integritetit të përshkruar në këtë Udhëzues, shqetësimet tuaja mund t'ia ngrini edhe pranë:

- Ekipit Drejtues të TAP-it (Drejtorit Menaxhues të TAP-it dhe anëtarëve të tjerë të Ekipit Drejtues të TAP-it)
- Eprorit tuaj të drejtpërdrejtë (për personelin e TAP-it)
- Përfaqësuesit të kontratës suaj me TAP-in (për palët e treta)
- Oficerit të Pajtueshmërisë së TAP-it
- Drejtorive Juridike ose të Burimeve Njerëzore të TAP-it.

Për kanale të tjera komunikimi, ju lutemi shihni faqen e Kontakteve të TAP-it.

2. KUSH MUND TË RAPORTOJË?

Çdo kandidat për punësim, punonjësit aktualë, ish punonjësit (përfshirë punonjësit në trajnim me dhe pa pagesë, vullnetarët dhe stazhierët), aksionarët e TAP-it dhe personat që i përkasin organeve drejtuese ose mbikëqyrëse të TAP-it, përfshirë anëtarët jo ekzekutivë, personat "freelance" dhe konsulentët, të gjithë personat që punojnë nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e kontraktorëve, nënkontraktorëve dhe furnitorëve, nëpunësit civilë, që punojnë për dhe me TAP-in, mund të raportojnë shkeljet e mbuluara nga ky Udhëzues ("Sinjalizues", ose "ju").

Ky Udhëzues zbatohet edhe për lehtësuesit, palët e treta që janë të lidhura me ju, të cilët mund të përballen me hakmarrje në kontekste të lidhura me punën (si kolegët apo të afërtit tuaj) dhe për subjektet juridike që ju keni në pronësi, për të cilët punoni ose me të cilët jeni të lidhur në mënyra të tjera në kontekstin e lidhur me punën.

3. ÇFARË MUND TË RAPORTONI?

Linja e Integritetit mund të përdoret për raportimin e shkeljeve sipas Legjislacionit Përkatës (sipas objektit të legjislacionit kombëtar transpozues, kur gjen zbatim). Ky Udhëzues nuk trajton raportimin e të gjitha veprimeve të gabuara.

Të Drejtat e Autorit të Rezervuara: Ky dokument nuk mund të kopjohet, t'u dorëzohet apo t'u vihet në dispozicion palëve të treta pa pëlqimin paraprak nga TAP AG. Versioni fundit i dokumentit është regjistrua në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Dokumentacionit të TAP-it.

Linja e Integritetit mund të përdoret për raportimin e shkeljeve (sjellje, veprime ose mosveprime) të dispozitave ligjore kombëtare ose të BE-së që dëmtojnë interesin publik ose integritetin e administratës publike apo një subjekti privat, lidhur me të cilat është marrë dijeni në kontekst punësimi publik ose privat. Më konkretisht këto shkelje mund të përfshijnë:

a) Keqbërje administrative, kontabiliteti, civile ose penale

a) Sjellje që përfshihen në Dekretin Ligjor Italian 231/2001, përfshirë shkeljet e Modelit 231 (Lutemi shihni Programin e Modelit 231 të TAP-it / Modello di Organizzazione Gestione e Controllo 231 në italisht), Kodin e Sjelljes së TAP-it

b) Shkeljet që trajtohen nga objekti i zbatimit të legjislacionit të BE-së apo atij kombëtar, përfshirë:
   - prokurimin publik (për sa gjen zbatim për TAP-in)
   - mbrojtjen mjedisore (si shkeljet kundër mbrojtjes mjedisore, rregullave për ndotjen, mbrojtjen e biodiversitetit)
   - Interesat financiare të BE-së (si mashtrimin, mitdhënien dhe mitmarrjen, korrupsionin, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit)
   - tregun e brendshëm (si legjislacionin e konkurrencës, tatimet e korporatës, ndihmën shtetërore)
   - privatësinë, mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit.

Linja e integritetit mund të përdoret edhe për raportimin e ngacmimit, dhunës dhe sjelljes së bullizmit. Megjithatë, mbrojtja e siguruar sipas Legjislacionit Përkatës është e kufizuar në raportimin e shkeljeve që janë pjesë e objektit të Legjislacionit Përkatës.

Ky Udhëzues nuk gjen zbatim për raportimet që lidhen me mosmarrëveshjet pretendimet, ose kërkesa të lidhura me punën/punësimin.

4. SI RAPORTOHET?

Linja e Integritetit është kanali i pavarur i TAP-it për raportimin e shkeljeve sipas objektit të përshkruar më lart. Nëse viheni në dijeni të një situate që ju e dini ose dyshoni se shkel Kodin e Sjelljes së TAP, politikat e TAP-it ose ligjet, sipas objektit të përshkruar më lart, ju inkurajojmë të raportoni. Grupi EQS, një palë e tretë e pavarur, e ndarë nga TAP-i, është përgjegjëse për funksionimin e Linjës së Integritetit që është e disponueshme 24/7.

Raportimi juaj duhet të bëhet gjithmonë me mirëbesim. Kur të raportoni, ju lutemi të jepni sa më shumë hollësi dhe fakte të jetë e mundur (si informacion mbështetës përfshirë e-mail-e, shënime dosjesh, fatura, etj.), sepse raportet e hartuara do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe hetimit.

Nëse e kërkoni, ju mund të raportoni në një takim ballë për ballë të caktuar brenda një afati të arsyeshëm, ose përmes Linjës së Integritetit me e-mail, përmes një formulari në internet në anglisht, shqip, greqisht ose italisht, ose përmes telefonit, përfshirë edhe përmes sistemeve të dërgimit të mesazheve. Nëse nuk dëshironi të identifikoheni, mund të raportoni **në mënyrë anonime**. Pavarësisht mënyrës që zgjidhni për raportimin, të gjitha raportet e keqveprimit faktik ose të dyshuar do të merren seriozisht dhe do të hetohen sa më shpejt. Megjithatë, jeni të inkurajuar të jepni emrin tuaj së bashku me raportin, me qëllim mbrojtjen e efektshme ndaj hakmarrjes së mundshme dhe menaxhimin më të mirë të raportimeve nëse lind nevoja e informacionit të mëtejshëm. Faktikisht, në rastin e raportimeve anonime, ju mund të mos kualifikoheni për mbrojtje si sinjalizues, nëse asgjë nuk e lidh raportimin me ju si individ. Për më tepër, shqetësimet e shprehura në mënyrë anonime nuk janë aq të fuqishme dhe trajtimi i efektshëm i tyre është më i vështirë. Megjithatë, ato do të merren në konsideratë dhe trajtohen nga TAP-i sa më tërësisht të jetë e mundur.

Ju mund të raportoni me shkrim ose me gojë, përmes mënyrave të mëposhtme:

- Të dërgoni një email në tap@tap.whistleblowerемail.com
- Plotësoni formularin në internet në adresën: https://tap.integrityline.com/frontpage
- Takim të drejtpërdrejtë me Oficerin e Pajtueshmërisë së TAP-it (tap@tap.whistleblowerемail.com) me kërkesën tuaj, që do të organizohet brenda një afati të arsyeshëm
- Thirrjes në numrin pa pagesë në vendin tuaj:

Të Drejtat e Autorit të Rezervuara: Ky dokument nuk mund të kopjohet, t'u dorëzohet apo t'u vihet në dispozicion palëve të treta pa pëlqimin paraprak nga TAP AG. Versioni fundit i dokumentit është regjistrua në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Dokumentacionit të TAP-it.

Switzerland +41 800 894 802 German, French, Italian, English
Greece: +30 800 491 423 829 Greek, English
Italy +39 800 727 428 Italian, English
Albania +35 580 015 22 Albanian, English

Ju lutemi të ndiqni hapat e mëposhtëm kur të përdorni numrat pa pagesë më lart:

1. Ju lutemi të zgjidhni gjuhën që dëshironi duke shtypur numrin përkatës
2. Ju lutemi të shtypni kodin e përcaktuar të shoqërisë për TAP-in **57966** (kjo do të sigurojë që raporti juaj do t'i caktohet/dërgohet TAP-it).
3. Do të dëgjoni tekstin e mirëseardhjes
4. Ju lutemi përzgjidhni nëse dëshironi të regjistroni raport të ri, ose nëse doni të dëgjoni mesazhet tuaja ardhese të ruajtura në mënyrë të sigurt, duke shtypur numrin përkatës që lidhet me raportin që keni regjistruar më parë.
5. Çdo raporti të ri i caktohet një numër çeshtje - **ju lutemi ta shënoni këtë numër dhe ta ruani atë.**

5. VLERËSIMI I RAPORTIT TUAJ

Vetëm Oficeri i Përputhshmërisë i TAP-it (i cili është përgjegjës për marrjen e raportit dhe është i caktuar si *Personi Përgjegjës për Marrjen e Raportit* për qëllimet e legjislacionit grek) ka qasje në raportin që ju bëni përmes Linjës së Integritetit.

Pasi raporti që ju keni bërë merret nga Oficeri i Përputhshmërisë i TAP-it, njoftimi për marrjen e tij bëhet brenda 7 ditësh nga marrja. Më tej do të informoheni nëse raporti është pjesë e objektit të këtij Udhëzimi dhe se kush tjetër mund të përfshihet në hetim (si Paneli Ngrije Zërin i TAP-it, Bordi i Vendimeve të Etikës dhe Përputhshmërisë, Bordi i Mbikëqyrjes së Modelit 231). Ju mund të ftoheni në / ju mund të kërkoni takim, i cili caktohet brenda një afati të arsyeshëm, gjatë të cilit mund të kërkohet informacion shtesë me shkrim, përveç rasteve kur raportimi është bërë në mënyrë anonime.

Nëse raporti juaj konsiderohet i pranueshëm, hapet një hetim lidhur me faktet e supozuara të raportit. Ju do të njoftoheni rregullisht lidhur me ecurinë e hetimit dhe nëse kërkohet informacion shtesë. Ju do të merrni informacion lidhur me situatën e hetimit, veprimet përkatëse, dhe do t'ju jepet mundësia të reagoni brenda një afati prej 40 ditësh për çështjet në Shqipëri dhe një afat prej tre (3) muajsh për çështjet në vendet e tjera nga data e njoftimit të marrjes së raportit. Rast pas rasti, Oficeri i Përputhshmërisë i TAP-it mund të mbështetet nga organet ose persona të brendshëm ose të jashtëm të TAP-it (si funksionet Juridike dhe të BNJ-ve të TAP-it, ose avokatë të jashtëm). Palët e përfshira të interesit do t'i nënshtrohet dispozitave të fshehtësisë ose në kuadër të kontratave përkatëse ose mbi bazën e detyrimit për fshehtësi lidhur me profesionin e tyre. Në varësi të rastit, mund të përfshihen edhe autoritete të caktuara si policia dhe autoritetet gjyqësore. Në fund të procesit hetimor, do të informoheni lidhur me rezultatin e procedurës së hetimit.

6. TË DREJTAT TUAJA

TAP-i do të shqyrtojë me kujdes të gjithë informacionin dhe raportet e marra. Lidhur me raportin tuaj dhe procesin e hetimit do të ndiqen parimet e mëposhtme:

- **Fshehtësia dhe mospublikimi.** Identiteti juaj, identiteti i individëve që përmendni në raportin tuaj, si dhe identiteti i individëve që ju mbështesin në raportimin tuaj (p.sh. lehtësuesit) do të mbrohen në mënyrën e duhur. Përputhshmëria e TAP-it, si edhe palët e tjera të interesit që mund të përfshihen në procesin e hetimit, janë të detyruara të ruajnë fshehtësinë. Identiteti juaj mund të bëhet publik vetëm me pëlqimin tuaj të shprehur dhe të lirë, ose kur ku publikim është i detyrueshëm për një hetim të ndërmarrë nga një autoritet kombëtar, ose gjatë procesit gjyqësor, bazuar në legjislacionin

Të Drejtat e Autorit të Rezervuara: Ky dokument nuk mund të kopjohet, t'u dorëzohet apo t'u vihet në dispozicion palëve të treta pa pëlqimin paraprak nga TAP AG. Versioni fundit i dokumentit është regjistrua në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Dokumentacionit të TAP-it.

përkatës. Nëse vërtetohet një situatë e tillë, ju do të njoftoheni sipas procedurave, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se hetimi apo procesi gjyqësor vihen në rrezik nga informimi juaj.

- **Ndalimi i hakmarrje dhe raportimi në mirëbesim.** Hakmarrja ndaj jush apo kujtdo që raporton ose bashkëpunon gjatë procesit të bërjes publike të informacionit në kuadër të këtij Udhëzuesi, është rreptësisht e ndaluar. TAP-i përqendrohet fuqimisht në krijimin e kanaleve të sigurta të raportimit dhe zbatimin e masave për parandalimin e hakmarrjes. Me qëllim ruajtjen e kulturës së integritetit, ju mbroheni gjatë raportimit në mirëbesim të shkeljeve të dyshuara ose faktike. Shembuj të hakmarrjes mund të përfshijnë: pezullimin, largimin, pushimin nga puna ose masa të barabarta me to; uljen në detyrë ose mos ngritjen në detyrë; ndryshimin e detyrave; shtrëngimin, frikësimin, ngacmimin ose dëbimin, diskriminimin, ose llojet e tjera të trajtimit të pafavorshëm. Raportimi në mirëbesim do të thotë që ju po jepni të gjithë informacionin që keni dhe që besoni se ky informacion është i vërtetë. Nëse besoni se janë hakmarrë ndaj jush, ju lutemi të këshilloheni me Përputhshmërinë e TAP-it, ose palët e tjera të renditura në seksionin 2 më lart. Raportimet e hakmarrjes do të hetohen tërësisht. Për më tepër, përvoja ka treguar se Linja e Integritetit rrallë përdoret për qëllime keqbërëse, por është e rëndësishme të kuptohet se përdorimi i Linjës së Integritetit me keqbesim për të përhapur gënjeshtra ose për të kërcënuar të tjerët, ose me qëllimin e dëmtimit të reputacionit të një personi tjetër në mënyrë të padrejtë, është i ndaluar dhe mund të ketë pasoja në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë sanksionet penale.

- **Pavarësia.** Linja e Integritetit është linjë tërësisht dhe plotësisht e pavarur që i përket Grupit EQS, që është person juridik i veçantë nga TAP-i. Megjithatë, TAP-i menaxhon raportet dhe shqetësimet e ngritura në lidhje me shoqërinë. Kështu, për shembull, TAP-i nuk mund të gjurmojë në asnjë mënyrë burimin e raportimeve të bëra në mënyrë anonime. Për më tepër, individët e përfshirë në marrjen e raportimit tuaj dhe në procesin hetimor, si Oficeri i Përputhshmërisë i TAP-it, janë të pavarur, kanë objektivitetin e duhur profesional, dhe kanë njohuritë, përvojën, kujdesin dhe besueshmërinë e nevojshme për administrimin e raporteve të trajtuara nga ky Udhëzim.

- **Mbrojtja e të dhënave personale.** Të dhënat personale nuk do të mblidhen nëse nuk është e nevojshme; dhe nëse mblidhen aksidentalisht, ato do të fshihen pa vonesa të panevojshme. Për më shumë hollësi për mënyrën e trajtimit dhe përpunimit të të dhënave personale nga ana e TAP-it në kuadër të këtij Udhëzuesi, ju lutemi shihni përkatësisht Njoftimet e Privatësisë.

Pa paragjykim për Linjën e Integritetit dhe këtë Udhëzues, ju lejohet të dorëzoni një raport të jashtëm në autoritetet kompetente në rastet e mëposhtme të përcaktuara nga Legjislacioni Përkatës:

- kur keni dorëzuar tashmë një raport të brendshëm që nuk është ndjekur nga TAP-i brenda afateve të përcaktuara në Legjislacionin Përkatës dhe në këtë Udhëzues;
- kur keni baza të arsyeshme për të besuar se raporti juaj nuk do të ndiqet në mënyrë të efektshme nga TAP-i, ose që ky raport ka rrezik mund të sjellë hakmarrje; dhe
- kur keni arsye të besoni se shkelja mund të shkaktojë rrezik të menjëhershëm ose të dukshëm ndaj interesit publik.

Në këto raste, mund të zgjidhni (i) të raportoni në organe të jashtme dhe të ngrini shqetësimet me autoritetet kombëtare kompetente: Autoriteti Italian Kundër Korrupsionit (ANAC), Autoriteti Kombëtar i Transparencës në Greqi (NTA), Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); dhe (ii) të raportoni në organet gjyqësore ose llogaridhënies.

Datë: 14 tetor 2026

Trans Adriatic Pipeline AG

Të Drejtat e Autorit të Rezervuara: Ky dokument nuk mund të kopjohet, t'u dorëzohet apo t'u vihet në dispozicion palëve të treta pa pëlqimin paraprak nga TAP AG. Versioni fundit i dokumentit është regjistrua në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Dokumentacionit të TAP-it.